

Në bazë të Nenit 16 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), punesimi i praktikantëve, në bazë të Programit të punës praktike "Kosovo Generation Unlimited" si dhe nevojës për punë praktike të departamenteve përkatëse, U.D. Kryeshefi Ekzekutiv i N.P"Termokos"Sh.A në Prishtinë, me datë: 18.03.2026 shpall këtë:

**KONKURS I JASHTËM PËR ANGAZHIMIN E PRAKTIKANTËVE**  
**NË KUADËR TË PROGRAMIT "Kosovo Generation Unlimited"**

**Titulli i pozitës: Praktikant në Departamentin Ligjor - një (1) vend pune**

**Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj**

**Lartësia e kompensimit mujor: 300.00€**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Pranon konsumatorë lidhur me obligimet, ankesat si dhe paditë e ushtruara (Propozimet për përmbardim)
- Ofron informacion mbi konsumatorët që nuk i kanë kryer obligimet në mënyrë që pastaj të nisen procedura përmbardimore;
- Mbanë evidencën e saktë të numrit të padive dhe parashtresave tjera nga dhe ndaj Ndërmarrjes dhe proceseve gjyqësore, administrative dhe të tjera, në të cilat Ndërmarrja është palë;
- Bënë mirëmbajtjen e saktë dhe të plotë të të gjitha lëndëve, materialeve dhe informatave në formë fizike dhe elektronike për Departamentin ligjor;
- Pranon Debitorët të cilët kanë lëndë në përmbardues privat dhe mbanë komunikim me përmbarduesit dhe debitorët etj.

**Kushtet dhe kriteret:**

- Të jetë student/e ose i/e diplomuar në Fakultetin Juridik
- Të jetë i/e moshës 16 deri në 24 vjeç
- Të ketë njohuri të punës me kompjuter (World, Exell, powerPoint etj),
- Të ketë aftësi komunikimi me palët,
- Njohja e gjuhës angleze e preferueshme.
- Kryen edhe punët tjera të cilat delegohen nga Departamenti Ligjor.

**Titulli i pozitës: Praktikant për mbështetje në sistemet GIS dhe menaxhimin e të dhënave - një (1) vend pune**

**Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj**

**Lartësia e kompensimit mujor: 300.00€**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Përditësimin dhe organizimin e të dhënave të rrjetit të ngrohjes qendrore në sistemet OGIS,
- Mbështetje në përgatitjen e dokumentacionit për digjitalizimin dhe sistemin e të dhënave hapësinore,
- Asistencë në analizat hapësinore dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me projektet e zhvillimit dhe zgjerimit të rrjetit,
- Mbështetje në përmirësimin e menaxhimit të informacionit teknik dhe të të dhënave të rrjetit.

**Kushtet dhe kriteret:**

- Të jetë student/e ose i/e diplomuar ne Gjeografi, Sisteme Informative Gjeografike (GIS), Planifikim Hapësinor, Inxhinieri Ndërtimore, Inxhinieri e Mjedisit ose fusha të tjera relevante që lidhen me analizën dhe menaxhimin e të dhënave hapësinore.
- Të jetë i/e moshës 16 deri në 24 vjeç
- Njohuri bazë në përdorimin e softuerëve GIS (ArcGIS, QGIS ose programe të ngjashme).
- Njohuri bazë në përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave hapësinore dhe statistikore.
- Aftësi për analizë dhe sistemim të të dhënave teknike.
- Njohuri të mira në përdorimin e programeve të paketës Microsoft Office (veçanërisht Excel).
- Aftësi për punë në ekip dhe komunikim profesional.

**Titulli i pozitës: Praktikant (Administratë dhe Burime Njerëzore) - dy (2) vende pune**

**Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj**

**Lartësia e kompensimit mujor: 300.00€**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Praktikanti do të angazhohet në mbështetje të aktiviteteve administrative në kuadër të Departamentit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore. Gjatë praktikës, ai/ajo do të ketë mundësi të:

- Njihet me proceset bazë të administratës dhe menaxhimit të dokumentacionit
- Asistojë në përgatitjen dhe sistemimin e dokumenteve në Burime Njerëzore
- Ndihmojë në përpunimin dhe regjistrimin e të dhënave sipas nevojës
- Njihet me procedurat e brendshme dhe rrjedhën e punës në institucion
- Mbështesë aktivitetet e përditshme administrative

**Kushtet dhe kriteret:**

- Të jetë student/e ose i/e diplomuar në Administratë, Ekonomi, Juridik apo fusha të ngjashme
- Të jetë i/e moshës 16 deri në 24 vjeç
- Njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit (Microsoft Office)
- Aftësi të mira organizative dhe komunikimi
- Gatishmëri për të mësuar dhe për t'u angazhuar në detyra të ndryshme administrative
- Saktësi dhe korrektësi në trajtimin e dokumenteve.

**Aplikantët e interesuar për vendet e punës duhet të bashkëngjisin këto dokumente:**

1. CV e përditësuar
2. Letër motivimi
3. Fotokopje e letërnjoftimit ose pasaportës
4. Dëshmi e studimeve (certifikatë studenti ose diplomë)

**Mënyra e aplikimit:**

Të gjithë të interesuarit duhet të regjistrohen si praktikant/e në platformën [www.kosovogenu.com](http://www.kosovogenu.com) dhe të aplikojnë në shpalljen e publikuar nga N.P"Termokos"Sh.A.

Dokumentacioni i plotë duhet të ngarkohet në platformën **Kosovo Generation Unlimited**. Pas aplikimit, do të pranoni një konfirmim nga ne. Nëse nuk e pranoni konfirmimin, ju lutem kontaktoni në nr. tel 038 541-780.

Konkursi për praktikant do të jetë i hapur në afat prej 15 ditësh nga data e publikimit në ueb faqe [www.termokos.org](http://www.termokos.org).

Mbyllja e konkursit bëhet më datë: 02.04.2026 ora 24.00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.